

Kodi i Praktikave të Punës për Punonjësit e
Përkujdesjes Sociale

dhe

Kodi i Praktikave të Punës për Punëdhënësit e
Punonjësve të Përkujdesjes Sociale

Shtator 2002

Punëdhënësit e Punonjësve të Përkujdesjes Sociale

Hyrje

Ky document përmban kodet e praktikave të miratuara për punonjësit e përkujdesjes sociale dhe punëdhënësve të tyre, duke përshkruar standartet e sjelljes dhe praktikave në bazë të të cilave ata duhet të punojnë. Kjo hyrje, e cila përfshihet edhe në Kodin e Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale, synon të ndihmojë për të kuptuar se çfarë janë këto norma dhe çfarë nënkuptojnë ato për punonjësin e përkujdesjes sociale, për punëdhënësin, atë që e përdor këtë shërbim dhe një pjestar të thjeshtë të publikut.

Këshilli Përgjithshëm i Përkujdesjes Sociale filloi punën më 1 Tetor 2001, në të njëjtën kohë me Këshillin e Përkujdesjes Sociale të Irlandës së Veriut, Këshillin e Shërbimeve Sociale të Skocisë dhe Këshillin e Përkujdesjes Sociale të Uellsit. Këto Këshilla kanë për detyrë të zhvillojnë kodet e praktikave të punës; ato kanë bashkëpunuar për hartimin e këtyre kodeve në kuadrin e kontributit për rritjen e standarteve të shërbimeve sociale

Kodi për punonjësit dhe ai për punëdhënësit janë paraqitur së bashku në këtë document sepse ata plotësojnë njëri tjetrin dhe pasqyrojnë përgjegjësinë e përbashkët të punonjësve dhe punëdhënësve për të siguruar standarte të larta.

Çfarë janë kodet?

Kodi i Praktikave për Punëdhënësit e Punonjësve të Përkujdesjes Sociale përcakton përgjegjësitë e punëdhënësve në rregullimin e aktivitetit punonjësve të shërbimeve sociale. Kjo është hera e parë që standarte të tilla parashtrihen në nivel kombëtar. Kodi kërkon që punëdhënësit tu përmbahen standarteve të parashtruara në të, të mbështesin punonjësit e shërbimeve sociale që të

përbushin detyrimet e tyre dhe të marrin masat e duhura kur punonjësit nuk iu përmbahen standarteve të miratuara të sjelljes.

Kodi i Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale është një listë deklarash që përshkruajnë standartet e sjelljes dhe praktikave profesionale të cilat kërkohet të zbatohen nga punonjësit e shërbimeve sociale në punën e tyre të përditëshme. Sërisht, kjo është hera e parë që standartet përcaktohen në këtë mënyrë në nivel kombëtar, edhe pse shumë punëdhënës zbatojnë standarte të ngjajshme në nivel lokal. Synimi është që të konfirmohen standartet që duhen zbatuar në shërbimet sociale dhe të sigurohet që punonjësit të kenë dijeni se çfarë standartesh sjelljeje presin prej tyre punëdhënësit, kolegët, përdoruesit e shërbimeve dhe njerëzit në përgjithësi.

Kodet synojnë të pasqyrojnë praktikat pozitive egzistuese. Pritet gjithashtu që punonjësit dhe punëdhënësit të identifikojnë në këto kode standartet e përbashkëta të cilat ata duhet të zbatojnë. Këshillat do t'i promovojnë këto standarte duke i vënë këto kode në dispozicion të publikut.

Si do të përdoren këto kode?

Kodet janë një hap i rëndësishëm në procesin e prezantimit të një sistemi rregullash për përkujdesjen sociale në katër pjesët e Mbretërisë së Bashkuar. Këshillat janë përgjegjëse për regjistrimin e të gjithë atyre që punojnë në sistemin e përkujdesjes sociale. Ky regjistër do të jetë një dokument publik që dëshmon se personat e regjistruar i kanë përmbushur kërkesat për tu përfshirë në këtë regjistër dhe kanë rënë dakort tu përmbahen standarteve të parashtruara në Kodin e Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale.

Këshillat do të kenë parasysh standartet e parashtruara në Kodin e Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale kur të shqyrtojnë çështje që janë në

kundravajtje me normat dhe marrin vendime nëse një punonjës i regjistruar duhet të qëndrojë në këtë profesion.

Si t'i kuptoni kodet?

Si punonjës i përkujdesjes sociale ju duhet të keni disa kritere që ju udhëzojnë në punën tuaj dhe ta keni të qartë se çfarë standartesh sjelljeje priten prej jush. Ju jeni të inkurajuar që t'i përdorni këto kode për të analizuar praktikën tuaj të punës dhe për të gjetur aspekte që mund t'i përmirësoni.

Si punëdhënës në sferën e shërbimeve sociale ju duhet të dini se çfarë roli duhet të luani në regullimin e aktivitetit të fuqisë punëtore dhe mbështetjen e një shërbimi me një cilësi të lartë. Jeni të inkurajuar që t'i rishikoni politikat dhe standartet e praktikave tuaja të punës nën dritën e standarteve të parashtruara në këtë kod.

Si përdorues i këtyre shërbimeve ose si pjestar i publikut, këto kode do t'ju ndihmojnë që të kuptoni se si një punonjës i shërbimeve sociale duhet të silllet me ju dhe si punëdhënësit duhet t'i mbështesin punonjësit e përkujdesjes sociale për ta bërë punën e tyre mire.

Kodi i Praktikave për Punëdhënësit e Punonjësve të Përkujdesjes Sociale

Qëllimi i këtij kodi është që të përcaktojë përgjegjësitë e punëdhënësve në regullimin e aktivitetit të punonjësve të përkujdesjes sociale. Regullimi i fuqisë punëtore ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përdoruesve të shërbimit dhe të punonjësve të përkujdesjes sociale. Ky kod synon të plotësojë dhe jo të zëvendësojë a të dublojë politikat egzistuese të punëdhënësve. Ai është pjesë e një pakete më të gjerë ligjesh, kërkesash dhe udhëzimesh që kanë të bëjnë me punësimin e personelit. Punëdhënësit kanë përgjegjësi që të sigurojnë përmbushjen e standarteve të parashtruara në këtë

kod, të sigurojnë shërbime me një cilësi të lartë dhe të ngjallin besimin e njerëzve në shërbimet e përkujdesjes sociale.

Statusi

Komisioni Kombëtar i Standarteve të Përkujdesjes dhe Inspektorati i Shërbimeve Sociale do të marrin për bazë këtë kod në procesin mbikqyrës së zbatimit të standarteve të përkujdesjes.

Për të përmbushur përgjegjësitë e tyre në lidhje me rregullimin e aktivitetit të fuqisë punëtore punëdhënësit e shërbimeve sociale duhet:

- Të sigurojnë që njerëzit janë të përshtatshëm për tu bërë pjestarë të fuqisë punëtore dhe të kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre;
- Të kenë në fuqi politika dhe procedura të shkruara për t'ju mundësuar punonjësve të përkujdesjes sociale që të përmbushin kërkesat e Këshillit të Përgjithëshëm të Përkujdesjes Sociale (GSCC) dhe të Kodit të Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale;
- Të sigurojnë mundësi për kualifikimin dhe zhvillimin e punonjësve të përkujdesjes sociale që ata të forcojnë dhe zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre;
- Të hartojnë dhe të zbatojnë politika dhe procedura të shkruara që trajtojnë rastet e sjelljeve dhe praktikave të rrezikshme, diskriminuese ose shfrytëzuese; dhe
- Të promovojnë kodet e praktikave të Këshillit të Përgjithëshëm të Përkujdesjes Sociale (GSCC) për punonjësit e përkujdesjes sociale dhe përdoruesit e shërbimeve dhe të bashkëpunojnë me procedurat e GSCC-së.

1 Si punëdhënës në shërbimet sociale ju duhet të siguroni që njerëzit të jenë të përshtatshëm për tu bërë pjesë të fuqisë punëtore dhe të kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Kjo përfshin :

- 1.1 Përdorimin e procedurave rigoroze dhe tërësore për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit. Këto procedura duhet të sigurojnë që vetëm kandidatët me njohuritë dhe aftësitë e duhura, dhe që janë të përshtatshëm të sigurojnë përkujdesje sociale, të lejohen për tu bërë pjesë e fuqisë tuaj punëtore;
- 1.2 Verifikimin e dokumentacionit nëse kandidati është dënues për vepra penale; verifikimin e regjistrave dhe indekseve si dhe vlerësimin nëse kandidatët janë të aftë për të zbatuar kërkesat e punës për të cilën janë zgjedhur, përpara se të bëhet konfirmimi i emërimeve;
- 1.3 Kërkesën dhe sigurimin e referencave të besueshme;
- 1.4 Dhënjen e një informacioni të qartë lidhur me rolet dhe përgjegjësitë e personelit, legjislacionin, politikën e procedurat organizative që ata duhet të ndjekin në punën e tyre; dhe
- 1.5 Monitorimin e mënyrës së kryerjes së detyrës nga personeli dhe nga organizata, për të siguruar një shërbim dhe përkujdesje me cilësi të lartë.

2 Si punëdhënës në shërbimet sociale ju duhet të keni në fuqi politika dhe procedura të shkruara për t'ju mundësuar punonjësve të përkujdesjes sociale që të përmbushin kërkesat e Këshillit të Përgjithshëm të Përkujdesjes Sociale (GSCC) dhe të Kodit të Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale;

Kjo përfshin :

- 2.1 Zbatimin dhe monitorimin e politikave të shkruara për: mirëbesimin, mundësitë e të drejtat e barabarta, vlerësimin e rrezikut, abuzimet, mbajtjen e evidences, dhe pranimin e të hollave ose dhuratave personale nga perdoruesit e shërbimit ose punonjësit e shërbimit;
- 2.2 Menazhimin dhe mbikqyrjen efektive të personelit për të mbështetur praktikat pozitive dhe sjelljen e mire si dhe ndihmën për personelin që ata të mund të korrigjojnë të metat në punën e tyre;
- 2.3 Vënjen në funksionim të sistemeve që u mundësojnë punonjësve të shërbimit të raportojnë për mungesën e burimeve materiale të përshtatshme ose vështirësitë operacionale që mund të pengojnë kryerjen e shërbimeve të sigurta si dhe bashkëpunimin me autoritetet përkatëse për trajtimin e këtyre problemeve; dhe
- 2.4 Mbështetjen e punonjësve të përkujdesjes sociale për të përmbushur kërkesat e Kodit të Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale të hartuar Këshilli i Përgjithëshem të Përkujdesjes Sociale (GSCC) dhe duke u kërkuar atyre që të mos bëjnë ndonjë gjë që vë në rrezik zbatimin e kodit.

3 Si punëdhënës në shërbimet sociale ju duhet të siguronit mundësi për kualifikimin dhe zhvillimin e punonjësve të përkujdesjes sociale që ata të forcojnë dhe zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre;

Kjo përfshin:

- 3.1 Sigurimin e mundësive për kualifikim dhe zhvillim për t'i ndihmuar punonjësit e përkujdesjes sociale që ta bëjnë punën në mënyrë të efektshme dhe për tu përgatitur për role dhe përgjegjësi të reja;

- 3.2 Ndhimën për sigurimin e edukimit dhe kualifikimit në fushën e përkujdesjes dhe punës sociale, përfshirë vlerësimin efektiv të vendit të punës dhe mësimet praktike;
- 3.3 Mbështetjen e personelit në postet që janë objekt i regjistrimit që ata të përmbushin kriteret e GSCC-së për regjistrimin dhe kërkesat e tij për zhvillimin e vazhdueshëm profesional; dhe
- 3.4 Reagimin në mënyrën e duhur ndaj kërkesave të punonjësve të përkujdesjes sociale për ndihmë kur ata nuk ndjehen të aftë ose të përgatitur siç duhet për të kryer ndonjë aspekt të punës së tyre.

4 Si punëdhënës në shërbimet sociale ju duhet të hartoni dhe të zbatoni politika dhe procedura të shkruara që trajtojnë rastet e sjelljeve dhe praktikave të rrezikshme, diskriminuese ose shfrytëzuese.

Kjo përfshin:

- 4.1 Sqarimin e punonjësve të përkujdesjes sociale se ngacmimet, presionet dhe çdo lloj forme e pajustificueshme diskriminimi janë të papranueshme si dhe marrjen e masave kundër sjelljeve të tilla;
- 4.2 Vënjen në funksionim dhe promovimin e procedurave me anë të të cilave punonjësit e përkujdesjes sociale të raportojnë rastet e sjelljeve dhe praktikave të rrezikshme, diskriminuese, abusive ose shfrytëzuese si dhe trajtimin e këtyre rasteve me shpejtësi, efektivitet dhe transparencë;
- 4.3 Sqarimin e punonjësve të përkujdesjes sociale, dhe të përdoruesve të shërbimit se dhuna, kërcënimet ose abuzimet me personelin janë të papranueshme; hartimin e politikave dhe procedurave të qarta për

zvogëlimin e rrezikut të dhunës si dhe menazhimin e incidenteve të dhunëshme;

- 4.4 Mbështetjen e punonjësve të përkujdesjes sociale të cilët përjetojnë trauma ose dhunë në punën e tyre;
- 4.5 Hartimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave të shkruara që kanë si përparësi mirëqenien e personelit dhe që ofrojnë mundësi të barabarta për punonjësit; dhe
- 4.6 Dhënjën përparësi përkujdesjes dhe sigurisë së përdoruesve të shërbimit krahas sigurimit të ndihmës së duhur për punonjësit e përkujdesjes sociale, puna e të cilëve preket nga ndonjë sëmundje ose nga efektet e drogës dhe alkoolit si dhe dhënjën e udhëzimeve të qarta lidhur me kufizimet në punën e tyre gjatë kohës që ata marrin mjekim.

5 Si punëdhënës në shërbimet sociale ju duhet të promovoni kodet e praktikave të Këshillit të Përgjithshëm të Përkujdesjes Sociale (GSCC) për punonjësit e përkujdesjes sociale dhe përdoruesit e shërbimeve dhe të bashkëpunoni me procedurat e GSCC.

Kjo përfshin:

- 5.1 Informimin e punonjësve të përkujdesjes sociale për këtë kod dhe përgjegjësinë tuaj për t'ju përmbajtur atij;
- 5.2 Informimin e punonjësve të përkujdesjes sociale për kodin e praktikave të Këshillit të Përgjithshëm të Përkujdesjes Sociale (GSCC) për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale dhe përgjegjësinë e tyre për të përmbushur kërkesat e tij;

- 5.3 Njohjen e përdoruesve të shërbimit dhe kujdestarëve me këtë kod dhe me Kodin e Praktikave të Punës së Punonjësve të Përkujdesjes Sociale dhe informimin e tyre për mënyrën se si mund t'i ngrenë problemet dhe, nëse është e nevojshme, se si mund të kontaktojnë GSCC-në lidhur me kodet;
- 5.4 Marrjen në konsideratë të Kodit të GSCC-së për Praktikën e Punës së Punonjësve të Përkujdesjes Sociale në marrjen e vendimeve që lidhen me sjelljen e punonjësve;
- 5.5 Njoftimin e GSCC-së për ndonjë shkelje të rregullave nga ana e punonjësve të përkujdesjes sociale që mund të vërë në dyshim anëtarësinë e tyre në profesion dhe vënjen në dijeni të punonjësit në fjalë se për të i është dërguar një raport GSCC-së; dhe
- 5.6 Bashkëpunimin me proceset hetimore e disiplinore të nisura nga GSCC-ja dhe marrjen e masave të duhura në përputhje me gjetjet dhe vendimet e GSCC-së.

Punonjësit e Përkujdesjes Sociale

Hyrje

Ky document përmban kodet e praktikave të miratuara për punonjësit e përkujdesjes sociale dhe punëdhënësve të tyre, duke përshkruar standartet e sjelljes dhe praktikave në bazë të të cilave ata duhet të punojnë. Kjo hyrje, e cila përfshihet edhe në Kodin e Praktikave të Punës për Punëdhënësit e Punonjësve të Përkujdesjes Sociale, synon të ndihmojë për të kuptuar se çfarë janë këto norma dhe çfarë nënkuptojnë ato për punonjësin e përkujdesjes sociale, për punëdhënësin, atë që e përdor këtë shërbim dhe për një pjestar të thjeshtë të publikut.

Këshilli Përgjithshëm i Përkujdesjes Sociale filloi punën më 1 Tetor 2001, në të njëjtën kohë me Këshillin e Përkujdesjes Sociale të Irlandës së Veriut, Këshillin e Shërbimeve Sociale të Skocisë dhe Këshillin e Përkujdesjes Sociale të Uellsit. Këto Këshilla kanë për detyrë të zhvillojnë kodin e praktikave të punës; ato kanë bashkëpunuar për hartimin e këtyre kodeve në kuadrin e kontributit për rritjen e standarteve të shërbimeve sociale

Kodi për punonjësit dhe ai për punëdhënësit janë paraqitur së bashku në këtë document sepse ata plotësojnë njëri tjetrin dhe pasqyrojnë përgjegjësinë e përbashkët të punonjësve dhe punëdhënësve për të siguruar standarte të larta.

Çfarë janë kodet?

Kodi i Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale është një listë deklaratash që përshkruajnë standartet e sjelljes dhe praktikave profesionale të cilat kërkohet të zbatohen nga punonjësit e shërbimeve sociale në punën e tyre të përditëshme. Kjo është hera e parë që standartet përcaktohen në këtë mënyrë në nivel kombëtar, edhe pse shumë punëdhënës zbatojnë standarte të ngjajshme në nivel lokal. Synimi është që të konfirmohen standartet që duhen zbatuar në shërbimet sociale dhe të sigurohet që punonjësit të kenë dijeni se çfarë standartesh sjelljeje presin prej tyre punëdhënësit, kolegët, përdoruesit e shërbimeve dhe njerëzit në përgjithësi.

Kodi i Praktikave për Punëdhënësit e Punonjësve të Përkujdesjes Sociale përcakton përgjegjësitë e punëdhënësve në rregullimin e aktivitetit punonjësve të shërbimeve sociale. Sërisht, kjo është hera e parë që standarte të tilla parashtrihen në nivel kombëtar. Kodi kërkon që punëdhënësit tu përmbahen standarteve të parashtruara në të, të mbështesin punonjësit e shërbimeve sociale që të përmbushin detyrimet e tyre dhe të marrin masat e duhura kur punonjësit nuk iu përmbahen standarteve të miratuara të sjelljes.

Kodet synojnë të pasqyrojnë praktikat pozitive egzistuese. Pritet gjithashtu që punonjësit dhe punëdhënësit të identifikojnë në këto kode standartet e përbashkëta të cilat ata duhet të zbatojnë. Këshillat do t'i promovojnë këto standarte duke i vënë këto kode në dispozicion të publikut.

Si do të përdoren këto kode?

Kodet janë një hap i rëndësishëm në procesin e prezantimit të një sistemi rregullash për përkujdesjen sociale në katër pjesët e Mbretërisë së Bashkuar. Këshillat janë përgjegjëse për regjistrimin e të gjithë atyre që punojnë në sistemin e përkujdesjes sociale. Ky regjistër do të jetë një dokument publik që dëshmon se personat e regjistruar i kanë përmbushur kërkesat për tu përfshirë në këtë regjistër dhe kanë rënë dakort tu përmbahen standarteve të parashtruara në Kodin e Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale.

Këshillat do të kenë parasysh standartet e parashtruara në Kodin e Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale kur të shqyrtojnë çështje që janë në kundërvajtje me normat dhe marrin vendime nëse një punonjës i regjistruar duhet të qëndrojë në këtë profesion.

Si t'i kuptoni kodet?

Si punonjës i përkujdesjes sociale ju duhet të keni disa kritere që ju udhëzojnë në punën tuaj dhe ta keni të qartë se çfarë standartesh sjelljeje priten prej jush. Ju jeni të inkurajuar që t'i përdorni këto kode për të analizuar praktikat tuaja të punës dhe për të gjetur aspekte që mund t'i përmirësoni.

Si punëdhënës në sferën e shërbimeve sociale ju duhet të dini se çfarë roli duhet të luani në rregullimin e aktivitetit të fuqisë punëtore dhe mbështetjen e një shërbimi me një cilësi të lartë. Jeni të inkurajuar që t'i rishikoni politikat dhe

standartet e praktikave tuaja të punës nën dritën e standarteve të parashtruara në këtë kod.

Si përdorues i këtyre shërbimeve ose si pjestar i publikut, këto kode do t'ju ndihmojnë që të kuptoni se si një punonjës i shërbimeve sociale duhet të silllet me ju dhe si punëdhënësit duhet t'i mbështesin punonjësit e përkujdesjes sociale për ta bërë punën e tyre mire.

Kodi i Praktikave të Punës për Punonjësit e Përkujdesjes Sociale

Qëllimi i këtij kodi është të përkufizojë standartet e sjelljes që pritet të zbatohen nga punonjësit e përkujdesjes sociale dhe të informojë përdoruesit e shërbimit dhe publikun lidhur me standartet që ata duhet të presin prej punonjësve të përkujdesjes sociale. Ai është pjesë e një pakete ligjesh, standartesh, politikash dhe procedurash të cilave punonjësit e përkujdesjes sociale duhet tu përmbahen. Punonjësit e përkujdesjes sociale kanë përgjegjësi për të siguruar që sjellja e tyre të mos bjerë nën standartet e parashtruara në kod dhe që asnjë veprim ose mos-veprim i tyre të mos dëmtojë mirëqenjen e përdoruesve të shërbimit.

Statusi

Këshilli i Përgjithshëm i Përkujdesjes Sociale pret nga punonjësit e përkujdesjes sociale që tu përmbahen normave të këtij kodi dhe mund të marrë masa nëse ndonjë prej punonjësve të regjistruar i shkel ato.

Punëdhënësve të punonjësve të përkujdesjes sociale u kërkohet që të kenë parasysh këtë kod kur marrin vendime lidhur me sjelljen e personelit të tyre.

Punonjësit e përkujdesjes sociale duhet:

- Të mbrojnë të drejtat dhe të promovojnë interesat e përdoruesve të shërbimit dhe të kujdestarëve;
- Të përpiqen të krijojnë dhe ruajnë besimin e përdoruesve të shërbimit dhe të kujdestarëve;
- Të promovojnë pavarësinë e përdoruesve të shërbimit ndërkohë që i mbrojnë ata sa të kenë mundësi nga cdo rrezik a dëmtrim;
- Të respektojnë të drejtat e përdoruesve të shërbimit ndërkohë që përpiqen të sigurojnë që sjellja e tyre të mos t'i dëmtojë ata ose të tjerët;
- Të ruajnë besimin publikut tek shërbimet e përkujdesjes sociale; dhe
- Të japin llogari për cilësinë e punës dhe të mbajnë përgjegjësi për ruajtjen dhe përmirësimin e njohurive dhe aftësive të tyre.

1 Si punonjës i përkujdesjes sociale ju duhet të mbronit të drejtat dhe të promovoni interesat e përdoruesve të shërbimit dhe të kujdestarëve.

Kjo përfshin:

- 1.1 Trajtimin e çdo personi si një individ;
- 1.2 Respektimin dhe aty ku është e nevojshme promovimin e pikpamjeve dhe dëshirave individuale të përdoruesve të shërbimit dhe të kujdestarëve;
- 1.3 Mbështetjen e të drejtave të përdoruesve të shërbimit për të kontrolluar jetën e tyre dhe për të bërë zgjedhjen që ata duan për shërbimet që marrin mbi bazën e një informacioni të plotë;

- 1.4 Respektimin dhe ruajtjen e dinjitetit dhe të konfidencialitetit të përdoruesve të shërbimit;
- 1.5 Promovimin e mundësive të barabarta për përdoruesit e shërbimit dhe kujdestarët; dhe respektimin e diversitetit dhe kulturave e vlerave të ndyshme.

2 Si punonjës i përkujdesjes sociale ju duhet të përpiqeni të krijoni dhe ruani besimin e përdoruesve të shërbimit dhe të kujdestarëve;

Kjo përfshin:

- 2.1 Të qënit i ndershëm dhe i besueshëm;
- 2.2 Komunikimin në një mënyrë të përshtatëshme, të hapur, të saktë dhe të drejtpërdrejtë;
- 2.3 Respektimin e informacionit konfidencial dhe shpjegimin në mënyrë të qartë të politikave të agjencisë lidhur me konfidencialitetin ndaj përdoruesve të shërbimit dhe kujdestarëve;
- 2.4 Të qënit një person i besueshëm ku përdoruesit e shërbimit të mund të gjejnë mbështetje;
- 2.5 Përmbylljen e detyrimeve dhe marrëveshjeve të punës dhe, kur kjo nuk është e mundur, shpjegimin e arsyeve përpara përdoruesve të shërbimit dhe kujdestarëve;
- 2.6 Deklarimin e çështjeve që mund të shkaktojnë konflikt interesash dhe sigurimin që ato nuk ndikojnë gjykimin ose praktikën që ju do të ndiqni; dhe

2.7 Zbatimin e politikave dhe procedurave të miratuara lidhur me pranimin e dhuratave dhe parave nga përdoruesit e shërbimit dhe kujdestarët.

3 Si punonjës i përkujdesjes sociale ju duhet të promovoni pavarësinë e përdoruesve të shërbimit ndërkohë që t'i mbronin ata sa të keni mundësi nga cdo rrezik a dëmtim;

Kjo përfshin:

3.1 Promovimin e pavarësisë së përdoruesve të shërbimit dhe ndihmën që ata të kuptojnë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre;

3.2 Zbatimin e proceseve dhe procedurave të miratuara për të përballur dhe raportuar sjelljet dhe praktikën e rrezikshme, abuzive diskriminuese ose shfrytëzuese;

3.3 Ndjekjen e praktikave dhe procedurave të hartuara për mbrojtjen e sigurisë tuaj dhe të njerëzve të tjerë ndaj sjelljeve të dhunëshme dhe abuzive në punë;

3.4 Sjelljen në vëmendje të punëdhënësit tuaj ose të autoriteteve përkatëse të vështirësive operacionale të cilat mund të bëhen pengesë për sigurimin e një përkujdesjeje të sigurt;

3.5 Informimin e punëdhënësit tuaj ose të autoriteteve përkatëse kur praktikën e ndjekura nga kolegët tuaj mund të çenojnë sigurinë ose të ndikojnë negativisht në standartet e përkujdesjes;

3.6 Veprimin në përputhje me politikën shëndetësore dhe të sigurisë të miratuara nga punëdhënësi, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me abuzime të mëdha;

- 3.7 Ndhimën për përdoruesit e shërbimit dhe kujdestarët që ata të parashtrojnë ankesat e tyre, trajtimin seriozisht të ankesave dhe zgjidhjen ose përcjelljen e tyre tek personat re duhur; dhe
- 3.8 Njohjen dhe përdorimin me përgjegjësi të kompetencave që burojnë nga puna me përdoruesit e shërbimit dhe kujdestarët.

4 Si punonjës i përkujdesjes sociale ju duhet të respektoni të drejtat e përdoruesve të shërbimit ndërkohë që përpiqeni të siguronit që sjellja e tyre të mos t'i dëmtojë ata ose të tjerë;

Kjo përfshin:

- 4.1 Pranimin e faktit se përdoruesit e shërbimit kanë të drejtë që të kenë parasysh rreziqet dhe ndihmën që u duhet dhënë atyre për të identifikuar dhe administruar rreziqet potenciale dhe aktuale ndaj tyre dhe të tjerëve;
- 4.2 Zbatimin e praktikave dhe procedurave për vlerësimin e rreziqeve për të përcaktuar nëse sjellja e përdoruesve të shërbimit përbën një rrezik që mund t'i dëmtojë ata ose të tjerët;
- 4.3 Marrjen e masave të nevojshme për të minimizuar rrezikun që përdoruesit e shërbimit të shkaktojnë dëme aktuale ose potenciale ndaj vetvetes ose të tjerëve; dhe
- 4.4 Marrjen e masave për të siguruar që kolegët dhe agjencitë e duhura të informohen lidhur me rezultatet dhe pasojat e prognozave.

5 Si punonjës i përkujdesjes sociale ju duhet të ruani besimin e publikut tek shërbimet e përkujdesjes sociale.

Në veçanti ju nuk duhet :

- 5.1 Të abuzoni, neglizhoni ose dëmtoni përdoruesit e shërbimit, kujdestarët ose kolegët;
- 5.2 Në asnjë mënyrë të shfrytëzoni përdoruesit e shërbimit, kujdestarët ose kolegët;
- 5.3 Të abuzoni me besimin e përdoruesve të shërbimit dhe kujdestarëve ose me të drejtën për të qënë në kontakt me të dhënat personale që kanë të bëjnë me pronat, shtëpinë dhe vendin e punës së tyre ;
- 5.4 Të krijoni marrëdhënje personale të papranueshme me përdoruesit e shërbimit ;
- 5.5 Të diskriminoni në mënyrë të paligjëshme ose të pajustificueshme përdoruesit e shërbimit, kujdestarët ose kolegët ;
- 5.6 Të heshtni ndaj çdo diskriminimi të paligjëshëm ose të pajustificueshëm nga përdoruesit e shërbimit, kujdestarët ose kolegët ;
- 5.7 Të vini veten ose të tjerët në ndonjë rrezik të panevojshëm; ose
- 5.8 Të silleni në ndonjë mënyrë, si në punë ose jashtë saj, që mund të vërë në dyshim përshtatshmërinë tuaj për të punuar në shërbimet e përkujdesjes sociale.

6 Si punonjës i përkujdesjes sociale, ju duhet të mbani përgjegjësi për cilësinë e punës suaj dhe për ruajtjen e përmirësimin e njohurive dhe aftësive tuaja.

Kjo përfshin:

- 6.1 Përbushjen e standarteve të praktikave përkatëse dhe kryerjen e punës në mënyrë të ligjëshme dhe të efektëshme;
- 6.2 Mbajtjen e evidencave të qarta dhe të sakta siç kërkohet nga procedurat e përcaktuara për punën tuaj;
- 6.3 Informimin e punëdhënësit tuaj ose të autoriteteve përkatëse lidhur me ndonjë vështirësi personale që mund të çënojë aftësinë tuaj për ta bërë punën me kompetencë dhe në mënyrë të sigurtë;
- 6.4 Të drejtën për të kërkuar ndihmë nga punëdhënësi ose autoritetet përkatëse në rastet kur ju nuk ndjeheni i aftë ose i përgatitur siç duhet për të kryer ndonjë aspekt të punës ose kur ju nuk jeni i sigurtë se si të veproni për ndonjë çështje pune ;
- 6.5 Të punuarit në mënyrë të sinqertë dhe në bashkëpunim me kolegët si dhe trajtimin e tyre me respekt ;
- 6.6 Njohjen e faktit se ju mbeteni përgjegjës për punën që ua keni deleguar punonjësve të tjerë ;
- 6.7 Njohjen dhe respektimin e rolit dhe ekspertizës së punonjësve nga agjenci të tjera dhe detyrën për të punuar në partneritet me ta; dhe
- 6.8 Kryerjen e kurseve kualifikuese përkatëse për të rruajtur dhe përmirësuar njohuritë dhe aftësitë tuaja si dhe dhënjen e ndihmës për kualifikimin e të tjerëve.

General Social Care Council
Goldings House
2 Hay's Lane
London
SE1 2HB

020 7397 5100
www.gsc.org.uk

© E drejta e botimit : General Social Care Council 2002